

Urdhri i Farmacistëve është ent publik jobuxhetor, i krijuar me ligji Nr. 9150, datë 30.10.2003 « Për Urdhrin e Farmacistëve në RSH », i ndryshuar, i cili përbëhet nga individët, që ushtrojnë profesionin e farmacistit në Republikën e Shqipërisë dhe përfaqëson interesat e tyre profesionale në nivel partneriteti institucional.

Urdhri i Farmacistëve mbikëqyr respektimin e të drejtave dhe detyrave të personave, që ushtrojnë profesionin e farmacistit në Republikën e Shqipërisë, sipas rregullave të Kodit të Deontologjisë Farmaceutike Shqiptare, për mbrojtjen e popullatës nga kequshtrimi i profesionit dhe cënimet e etikës farmaceutike, si dhe nga veprime të tjera që privojnë kujdesin e nevojshëm farmaceutik.

Urdhri i Farmacistëve mbron farmacistët nga veprimet arbitrare të administratës publike ose private për ushtrimin e profesionit.

Urdhri i Farmacistëve garanton që anëtarët e Urdhrit përmbushin detyrimet e programit të ricertifikimit të vendosur nga institucioni përkatës.

Anëtarë të Urdhrit të Farmacistëve bëhen individët, shtetas shqiptarë, të diplomuar farmacistë në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, që pranojnë Kodin Deontologjik Farmaceutik Shqiptar dhe që e ushtrojnë këtë profesion në sektorin e prodhimit farmaceutik, të shërbimit dhe të shpërndarjes farmaceutike, ambulator e spitalor, publik dhe privat, ose në sektorë të tjerë të shëndetësisë.

Përfshihen nga ky detyrim, por jo nga e drejta e anëtarësimit në Urdhrin e Farmacistëve, farmacistët funksionarë të administratës publike, për sa kohë që ata nuk ushtrojnë veprimtari të mirëfilltë profesionale farmaceutike.

Shtetasit e huaj, për ushtrimin e profesionit të farmacistit në sektorin farmaceutik të Republikës së Shqipërisë, janë të detyruar të anëtarësohen në Urdhrin e Farmacistëve, të njohin dhe të zbatojnë Kodin e Deontologjisë Farmaceutike Shqiptare, si dhe të gjitha aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë shërbimin farmaceutik dhe atë shëndetësor në Republikën e Shqipërisë.

Asnjë individ nuk mund ta ushtroje profesionin e farmacistit në Republikën e Shqipërisë, pa qenë anëtar i Urdhrit të Farmacistëve.

Punëdhënësit në institucionet a ndërmarrjet shtetërore ose publike dhe në subjektet private ndalohen t'i punësojnë ata në kundërshtim me këtë dispozitë.

Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Farmacistëve përcakton kriteret për pranimin e farmacistëve në këtë urdhër.

Urdhri i Farmacistëve, gjatë kryerjes së detyrave, mban lidhje të vazhdueshme, nëpërmjet përfaqësimit ndërinstytucional, me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë, me institucionet e saj vartëse si dhe me ministritë e tjera, me institucionet qendrore dhe organizma të tjerë publikë ose jopublikë, të krijuar sipas legjislacionit në fuqi.

Urdhri i Farmacistëve informon çdo 6 muaj ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë lidhur me anëtarësimet, gjykimet disiplinore dhe probleme të tjera me interes të ndërsjellë. Ky informacion publikohet edhe në faqen e internetit të Urdhrit.

Ministria përgjegjëse për shëndetësinë bashkëpunon me Urdhrin e Farmacistëve për hartimin e projektligjeve dhe të dokumenteve të rëndësishme në fushën farmaceutike.

Urdhri i Farmacistëve ka buxhetin e vet, te cilin e administron në përputhje me rregullat financiare në fuqi. Të ardhurat e realizuara gjatë ushtrimit të veprimtarisë së vet, Urdhri i Farmacistëve i përdor për të përmbushur misionin e caktuar në ligj.